

21.06.2004

## KORNIZA E PLATFORMËS

Në mbështetje të Marrëveshjes për themelimin e Këshillit Koncesual Politik të Partive Politike Shqiptare të Luginës së Preshevës si dhe të Rregullores së punës, KKP i pakënaqur me shkallën e lirisë e të barazisë mes qytetarëve, pozitën juridiko – kushtetuese të popullit shqiptar, zhvillimin ekonomik në vend, procesin e privatizimit të pronës shoqërore, pozitën e pabarabartë në sferën e arsimit, militarizimin e sërishëm të rajonit e me dëshirë që me mjete politike e demokratike, në mënyrë sa më efektive t'i tejkalojë këto dukuri, konform standardeve ndërkombëtare dhe në bazë të:

1. Kartës së Kombeve të Bashkuara
  2. Deklaratës së përgjithshme për të drejtat e njeriut
  3. Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore
  4. Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
- sjell këtë:

## PLATFORMË

### PARIMET

Realizimi i të gjitha të drejtave të shqiptarëve të Luginës së Preshevës që janë të garantuara me dokumente ndërkombëtare.

Ngritja e sigurisë së qytetarëve, garantimi i qarkullimit të lirë të njerëzve dhe kapitalit si dhe demilitarizimi i këtij rajoni.

Krijimi i kushteve të volitshme për një zhvillim të shpejtuar ekonomik.

Lugina e Preshevës, të organizohet si rajon specifik autonom në frymën e referendumit të 1 dhe 2 marsit të vitit 1992.



## KORNIZA E PLATFORMËS

- E drejta dhe krijimi i kushteve për shkollim në gjuhën amtare në Luginë të Preshevës, që nga arsimit parashkollor e deri në atë superior, si dhe krijimi i kushteve për arsimim të fëmijëve me të meta psiko-fizike, kurse planprogramet të jenë të harmonizuara në përputhje me historinë dhe kulturën kombëtare. Garantimi i përdorimit të lirë të teksteve mësimore në të gjitha nivelet e shkollimit nga Kosova ose Shqipëria.
- Përdorimi i gjuhës dhe shkrimit shqip në organet dhe institucionet shtetërore si dhe garantimi i së drejtës së përdorimit të lirë të simboleve kombëtare.
- Lugina e Preshevës të demilitarizohet nga forcat policore dhe ushtarake nën mbikëqyerje të faktorit ndërkombëtarë. Përgjegjësinë për sigurinë në këtë rajon ta marrë mbi vete policia vendore, të cilës duhet t'i jipen kompetencat.
- Të garantohet pjesëmarrja e shqiptarëve në institucionet lokale, rajonale dhe ato shtetërore, duke pasur për bazë strukturën nacionale të popullsisë.
- Gjerë në krijimin e mirëbesimit mes shqiptarëve dhe institucioneve dhe anasjelltas, shqiptarët të mos rekrutohen në armatën serbo-malazeze.
- Në afat sa më të shkurtër të filloj procesi i privatizimit të subjekteve shoqëro-ekonomike, me çka do të krijoheshin mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës.
- Të garantohet qarkullimi i lirë i njerëzve dhe i mallrave, në veçanti, hapja e vendkalimeve kufitare të kategorisë së dytë - lokale në drejtim të Maqedonisë.
- Qeveria Republikane, t'i intensivtoj aktivitetet rreth përkrahjes financiare të projekteve të ndryshme në infrastrukturë dhe veprimtari shoqërore, si dhe të vazhdohet me kompensimin e dëmeve të luftës.
- Në afat sa më të shkurtër të thirret një konferencë donatorësh për përkrahjen e projekteve në lëminë e infrastrukturës, zhvillimit ekonomik, e sidomos nxitja e realizimit të projekteve të ekonomisë së vogël.
- Shpallja e rajonit të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit si zonë e lirë tregtare dhe doganore.
- Të respektohet vendimi i ish Qeverisë Federative dhe Republikane, mbi amnestinë e ish pjestarëve të UÇPMB-së dhe të ndërpriten të gjitha procedurat gjyqësore dhe ndjekëse të motivuara politikisht ndaj të të njejtëve.



- Të sigurohet mbrojtja shëndetësore e tërë popullatës së rajonit të Luginës së Preshevës me ate që synimet e zgjidhjes së problemeve të kapaciteteve funksionale shëndetësore të orientohen në:
  - sigurimin e numrit të mjaftueshëm të kuadrove dhe profileve të nevojshëm, si dhe përsosjen profesionale dhe permanente të tyre,
  - zgjerimin e dhënies (ofrimin) së mbrojtjes shëndetësore duke zgjeruar rrjetin, ngritjen e kapaciteteve të reja apo zgjerimin e atyre ekzistuese,
  - ndarja racionale e punës shëndetësore dhe veprimi i koordinuar i shëndetësisë primare, poliklinike dhe asaj stacionare (spitalore), me çka bëhet i mundur ofrimi i mbrojtjes complete (të tërësishme) shëndetësore.
- Të themelohen institucione për mbrojtjen e kategorive të njerëzve të rrezikuar, e sidomos të pleqve dhe atyre që janë pa mbikqyrje adekuate.
- Për t'i realizuar të drejtat dhe nevojat e lartpërmendura si dhe duke pasur parasysh rrjedhat në rajon, pasi që rajoni i Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës është pjesë e natyrshme e kontinuitetit etnik, gjuhësor, kulturor e territorial shqiptar mbi të cilin janë imponuar ndarje pa vullnetin e popullit, për momentin është e domosdoshme që në kuadër të kushtetutës së re, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci të definohen si rajon i posaçëm autonom me emërtim "Luginë e Preshevës".
- Gjatë bisedimeve që do të organizohen për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës, në mes të palës kosovare dhe asaj serbe, shqiptarët e Luginës së Preshevës të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në këto bisedime.
- Statusi përfundimtar politik i Luginës së Preshevës të zgjidhet bashkë me zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës, konform referendumit të 1 dhe 2 Marsit të vitit 1992.

**Në Preshevë  
Më 21.06.2004**

**Këshilli Koncesual Politik i Partive Politike  
Shqiptare të Luginës së Preshevës**

**Nënshkrues:**

**PDSH – Ragmi Mustafa**

**LPD – Jonuz Musliu**

**BDL – Skender Destani**

